



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

RREGULLORE E PUNËS
SË KUVENDIT

Prishtinë, Nëntor 2022

Në bazë të nenit 31 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, Kuvendi i Federatës Atletike të Kosovës, në seancën e mbajtur më 30 nëntor 2022, miratoi këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË KUVENDIT

(I) DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e punës dhe vendimmarrja e Kuvendit të Federatës Atletike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi).

Në qoftë se një dispozitë e organizimit dhe punës së Kuvendit nuk përcaktohet nga kjo rregullore apo Statutin e FAK-ut, Kuvendi e rregullon këtë çështje me një akt të veçantë.

Neni 2.

Kuvendi si organ më i lartë i Federatës Atletike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm FAK), kryen punët dhe detyra, në përputhje me dispozitat e Statutit të FAK-ut dhe kësaj rregulloreje.

Kuvendi punon në seanca.

Neni 3.

Mandati i delegatit në Kuvend përcaktohet nga Anëtari dhe duhet të vërtetohet në FAK çdo vit. Anëtari i Federatës mund të emërojë zëvendësues.

(II) KONSTITUIMI I KUVENDIT

Neni 4.

Seancën e parë zgjedhore të Kuvendit e thërret dhe përgatit kryetari dhe bordi i FAK-ut i përbërjes së vjetër.

Seancën e Kuvendit e hap kryetari i FAK-ut dhe me punën e tij udhëheqë deri në zgjedhjen e re të kryetarit të FAK-ut. Në rast të mungesës së kryetarit, Kuvendin e hap, dhe punën e tij e kryen njëri prej nënkryetarve të FAK-ut. Nëse në seancë nuk janë prezent as Kryetari as nënkryetari i FAK-ut, Kuvendin e hap anëtari më i vjetër i Bordit.

Kryetari ka kompetenca të cilat me këtë rregullore u janë dhënë kryetarit të FAK-ut në menaxhimin e seancave të rregullta të Kuvendit.

Neni 5

Seanca e Kuvendit është publike. Kuvendi mund të vendosë në diskutimin dhe vendimmarrjen në lidhje me pikat e veçanta të rendit të ditës, të mbajë seancën pa prezencën e publikut.

Neni 6

Bordi i FAK-ut si organizator i seancës, vendosë se cilëve persona, përveç anëtarëve (delegatëve) të Kuvendit, ti dërgoj ftesë që të marrin pjesë në seancë si monitorues, mysafir.

Neni 7

Pas hapjes së seancës, Kuvendi, me propozim të delegatëve zgjedhë Kryesinë e punës së kuvendit e cila përbëhet nga tre anëtarë, të cilët udhëheqin punën e Kuvendit zgjedhor. Njëri prej anëtarëve të Kryesisë së punës duhet të marrë rolin e udhëheqësit.

Neni 8

Kryesia e punës merr parasysh mbarëvajtjen e seancës në përputhje me dispozitat e Statutit dhe kësaj rregulloreje, si dhe ruajtjen e rendit në mbledhjet e tij. Në rast të çrregullimit serioz të rendit në seancë ose sjelljes që është në kundërshtim me parimet e korrektësisë dhe etikës, Kryesia e punës mund t'i propozojë Kuvendit që kryeseve t'ju vendosë një prej masave të mëposhtme: paralajmërim, qortim ose përjashtim nga seanca.

Neni 9

Pas zgjedhjes dhe konstituimit të Kryesisë së punës, Kryesia propozon dhe Kuvendi miraton si vijon: 3 anëtarë të Komisionit të Verifikimit, një Procesmbajtës, një Verifikues të procesmbajtësit.

Neni 10

Seanca e parë e Kuvendit të ri ka rendin e ditës si më poshtë:

- Zgjedhja e Kryetarit të FAK-ut,
- Zgjedhja e anëtarëve të Bordit drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës të FAK-ut,

Në rendin e ditës së këtij Kuvendi mund të vendosen pika të tjera që zgjidhin çështje të rëndësishme të sportit të atletikës në Kosovë.

Neni 11

Komisioni verifikues ofron pasqyrë në praninë e anëtarëve të Kuvendit, besueshmërinë e autorizimit të lëshuar nga Anëtarët e FAK-ut dhe raporton në Kuvend për këtë.

Në Komisionin verifikues do të zgjidhen tre anëtarë të Kuvendit.

Komisioni Verifikues zgjidhet me shumicë votash.

Neni 12

Nëse mandati i dikujt nga të pranishmit është i diskutueshëm, Kuvendi së pari zgjidh verifikimin e anëtarëve të pa diskutueshëm, dhe pastaj kalon në kontrollin dhe vendimin individual për mandatet e diskutueshme.

Anëtarit të Kuvendit zgjedhor të cilit i është kontestuar pjesëmarrja, nuk mund të merr pjesë në votim për të verifikuar mandatin e tij.

Neni 13

Bazuar në raportin e Komisionit Verifikues, Kuvendi vendos që zgjedhja e anëtarëve të Kuvendit të shtyhet për mbledhjen e ardhshme ose të refuzohet konfirmimi i mandatit.

Neni 14

Kandidat për kryetar mund të propozohet nga çdo anëtar i Federatës me të drejtë vote, së paku 15 ditë para Kuvendit. Kandidati për kryetar duhet të plotësoj kushtet e përcaktuara me ligj, statut dhe rregullore të Federatës dhe të paraqet një CV, planin dhe programin e atletikës për 4 vitet e ardhshme.

Pastaj hapet debat për kandidatët e propozuar dhe çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të shpreh mendimin e tij.

Kandidati për kryetar duhet të paraqesë programin e tij dhe t'iu përgjigjet pyetjeve të delegatëve të Kuvendit.

Neni 15.

Pas përfundimit të debatit të Kuvendit, formohet lista e të propozuarave për kandidat të mundshëm për kryetar.

Neni 16.

Procesi i zgjedhjes së kryetarit të FAK-ut vazhdon, nëse pas zgjedhjes së parë asnjë kandidat nuk merr numrin e kërkuar të votave, të cilën e përcakton Statuti i FAK-ut. Nëse lista përmban më shumë se dy kandidatë në raundin e ardhshëm të zgjedhjeve do të kandidojnë vetëm dy kandidat që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë.

Nëse edhe pas votimit përsëritës nuk arrin të zgjidhet kryetari i FAK-ut, procedura e përzgjedhjes vazhdon me ri-propozimin e kandidatëve të rinj me procedurë të shpejtë (aty për aty).

Nëse ka vetëm një kandidat për kryetar ai duhet të votohet nga shumica e delegatëve me të drejtë vote për të marrë mandatin e kryetarit.

Neni 17.

Kryetari i FAK-ut merr detyrën, pas publikimit të rezultateve të zgjedhjeve për kryetar të FAK-ut dhe më tutje merr udhëheqjen e seancës së kuvendit.

Neni 18.

Kryetarit të FAK-ut i pushon funksioni para skadimit të mandatit, me dorëheqje ose shkarkimin nga Kuvendi i FAK-ut.

Kryetari i FAK-ut mund të paraqesë një kërkesë për dorëheqjen e tij.

Propozimi për dorëheqje duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të shpjegohet.

Propozimin për shkarkim mund ta paraqes Bordi ose të paktën 1/2 e delegatëve të Kuvendit.

Shkarkimi i kryetarit të FAK-ut bëhet në mënyrën dhe sipas procedurave të parashikuara për zgjedhjen e tij.

Seancën në të cilën vendoset për shkarkimin nuk mund të drejtojë personi të cilit i adresohet shkarkimi.

Neni 19.

Kuvendi zgjedhë Bordin Drejtues dhe Këshillin Mbikëqyrës.

Me propozim paraprak të anëtarëve (7 ditë para mbajtjes së kuvendit) formohen listat e kandidatëve për anëtarë të Bordit dhe Këshillin Mbikëqyrës,

Kuvendi zgjedh 7 (shtatë) anëtarë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Federatës ku dy duhet të jenë të gjinisë femërore.

Në rast se një anëtar i Bordit Ekzekutiv pengohet dhe nuk ka mundësi të kryejë detyrat e tij, apo mungon tri herë radhazi pa arsye në mbledhje të Bordit Ekzekutiv, Kryetari në mbledhjen e radhës së Bordit duhet të propozoj zgjedhjen e një anëtari të ri të Bordit Ekzekutiv në bazë të numrit të votave të grumbulluara nga Kuvendi zgjedhor paraprak. Nëse numri i votave të fituara të delegatëve është i barabartë, atëherë hedhet short për delegatët e barabartë.

(III) SEANCAT E KUVENDIT

Neni 20.

Përgatitjen e seancave e bënë kryetari i FAK-ut me ndihmën e Sekretarit të përgjithshëm të FAK-ut.

Kryetari i FAK-ut fut në propozim të rendit të ditës propozimet të marra nga anëtarët e Kuvendit dhe të autoriteteve, organeve dhe personave të autorizuar për të paraqitur propozimet.

Kryetari i FAK-ut siguron se të gjitha çështjet janë futur në propozim të rendit të ditës që do të diskutohen më parë edhe në mbledhjen e Bordit të FAK-ut.

Neni 21.

Seancat e Kuvendit do të thirren në formë të shkruar. Është e nevojshme që thirrja të përmban vendndodhjen, kohën mbajtjes dhe rendin e ditës të seancës, si dhe materialet për kuvend.

Gjithsesi duhet të dorëzohen në tërësi: teksti i propozimit të akteve të përgjithshme, raportet dhe analizat që duhet diskutuar në takim.

Shtatë ditë para seancës, të gjitha materialet për takimin do t'u vihen në dispozicion anëtarëve të Kuvendit me ndihmën e sekretarit të përgjithshëm të FAK-ut.

Njoftimi i seancës duhet t'ju dorëzohet anëtarëve të Kuvendit jo më vonë se shtatë ditë para takimit. Kur ka një arsye legjitime kjo periudhë mund të jetë më e shkurtër.

Neni 22.

Propozimin e rendit të ditës e përpilon kryetari i FAK-ut.

Kryetari mund të refuzojë që në propozim të rendit të ditës të fut ato propozime që ka pranuar nga autoritetet apo personat për të cilat mendon se nuk janë mjaftueshme të përgatitura që të mund të diskutohet në seancë. Në këtë rast, Kryetari do të njoftojë propozuesit për arsyet pse ai hodhi poshtë propozimet.

Neni 23.

Para përcaktimit të rendit të ditës, Kryetari i FAK-ut sipas raportit nga Sekretari i Përgjithshëm i FAK-ut, të përcakton nëse ka kuorum për seancën e Kuvendit.

Anëtarët e kuvendit kanë për detyrë të paktën 48 orë përpara fillimit të planifikuar të seancës që të informojnë Sekretarin e përgjithshëm të FAK-ut për pamundësinë për të marrë pjesë në seancë.

Në qoftë se konstatohet se nuk ka kuorum, Kryetari do të shtyjë seancën e Kuvendit për ditën dhe orën e caktuar.

Në qoftë se në rrjedhën e seancës kryetari i FAK-ut dyshon se kuorumi është i pamjaftueshëm, do të urdhërojë të bëhen telefonata ose numërime. Thirrja ose numërimi do të bëhet nëse kërkohet nga njëri prej anëtarëve të Kuvendit për të përcaktuar kuorumin.

Neni 24

Kur kryetari i FAK-ut konstaton se ka kuorum fillon edhe përcaktimi i rendit të ditës. Secili anëtar i Kuvendit mund të kërkojë që në rendin e ditës të futen çështjet përpos atyre që jep kryetari, propozime dhe çështje të tjera që i konsiderojnë se janë urgjente. Anëtar i Kuvendit është i detyruar që urgjencën e çështjeve apo propozimeve ta shpjegoj.

Neni 25

Për rendin e ditës së seancës vendoset pa diskutim (debat).

Rendi i ditës do të përcaktohet me shumicën e votave të Kuvendit.

Neni 26

Kryesuesi, në lidhje me çdo çështje në rendin e ditës, para hapjes së diskutimit, jep fjalën raportuesit, ose parashtruesit të propozimit të caktuar.

Neni 27

Në seancën e Kuvendit, çdo anëtar ka të drejtë të flasë.

Kur diskutohen çështje nga fushëveprimi i Komisioneve të Kuvendit, kanë të drejtën e fjalës dhe pjesëtarët e komisioneve të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit.

Neni 28

Anëtarët e Kuvendit për diskutim lajmërohen me ngritje të dorës, kurse kryetari i jep fjalën sipas radhës që të interesuarit janë lajmëruar. I njëjti person nuk mundet në pikën e njëjtë të rendit të ditës të flasë më shumë se dy herë.

Neni 29

Kryetari mund të propozojë që kohëzgjatja e diskutimit të kufizohet sipas kohës dhe që secili pjesëmarrës në diskutim për të njëjtën çështje të diskutoj vetëm një herë. Kufizimin e kohëzgjatjes së fjalimit mund ta propozojë çdo anëtar i Kuvendit.

Në rast të tejkalimit të kohëzgjatjes së rënë dakord të fjalës Kryetari paralajmëron folësin, dhe nëse folësi nuk e përfundon fjalimin kryetari do t'ia merr fjalën.

Neni 30.

Anëtarit të Kuvendit i cili dëshiron të flasë në lidhje me shkeljen e kësaj rregulloreje apo shkeljen të rendit të ditës, kryetari i jep fjalën në momentin kur kjo është kërkuar. Ekspozimi i anëtarëve të Kuvendit nuk mund të zgjasë më shumë se tre minuta. Nëse një anëtar i Kuvendit nuk është i kënaqur me shpjegimin e Kryetarit, çështja vendoset nga Kuvendi, pa debat.

Neni 31.

Nëse një anëtar i Kuvendit ka kërkuar fjalën për të korigjuar deklaratën që vlen për atë apo organizatën së tij që ai përfaqëson, merr fjalën në fund të këtij diskutimi, atij që i ka parashtruar akuzat. Në fjalën e tij duhet të kufizohet në korigjimin e zonës së diskutueshme dhe mund të zgjasë vetëm tre minuta.

Neni 32

Folësi mund të flas vetëm për çështje që janë në rendin e ditës.

Nëse folësi largohet nga rendi i ditës, Kryetari thërret për ta paralajmëruar atë që të rri në rendin e ditës, ose mundet, në qoftë se ai nuk e ndryshon diskutimin, t'ia marr fjalën.

Neni 33.

Vendimet merren pas diskutimit me përjashtim të rasteve kur në këtë rregullore, është vendosur që të vendoset pa debat.

Kryetari mund t'i propozojë Kuvendit përfundimin e debatit para se të kryhet diskutimi i folësit të regjistruar, nëse e konsideron se çështja është diskutuar mjaftueshëm. Për këtë propozim votohet pa diskutim.

Neni 34.

Pas diskutimit kryetari vendos një ose më shumë propozime të cilat do të vendosen me votim. Para ose pas seancës, Kuvendi mund të vendosë që një pyetje të veçantë ta heqë nga rendi i ditës.

Neni 35.

Kuvendi mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se shumica e anëtarëve të Kuvendit janë prezent.

Vendimet merren me shumicën e votave të Kuvendit, përveç nëse me statut të FAK-ut është dhënë ndonjë shumicë tjetër.

Neni 36.

Vendimet merren me votim të hapur, me ngritje të dorës të anëtarëve të Kuvendit, ose me votim të fshehtë nëse e kërkojnë shumica e delagatëve.

Neni 37.

Pas përfundimit të diskutimit dhe vendimmarrjes në lidhje me të gjitha çështjet që kanë qenë në rendin e ditës Kryetari përfundon seancën. Procesmbajtësi do të përmbledhë një shënim me shkrim të seancës, në përputhje me dispozitat e Statutit të FAK-ut. Verifikuesi është i obliguar që me nënshkrimin e tij të garantoj saktësinë e përmbajtjes së tij.

Neni 38.

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi pas miratimit të saj nga Kuvendi dhe do të zbatohet menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i FAK-ut.

Prishtinë, më
30.11.2022



Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Halil Sylejmani', written over the printed name and partially overlapping the official seal.